



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.20/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj Kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Laziç, anëtarë dhe me zyrtarin ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e Blerta Greiçevci nga Dekal Illinois – SHBA, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të mos përfshirjes në Listën e Votuesve Jashtë Kosove, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit i mbajtur me datë 31.05.2017, mori këtë:

**V E N D I M**

**Hidhet** si i palejuar apeli Anr.20/2017 e datës 29.05.2017 e parashtruar nga Blerta Greiçevci, aplikuese për votim jashtë Kosove.

**Arsyetim**

PZAP-i, me datën 29.05.2017 e ka pranuar një apel nga Blerta Greiçevci për momentin banore e SHBA-së, në të cilën apel pretendon se me datën 22.05.2017 në orën 06:31 e ka ushtruar të drejtën për votim jashtë Kosove për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 11 Qershor 2017. Parashtruesja e apelit ka theksuar se formularin për votim jashtë Kosovës e ka dërguar në email adresën [ovp@kqz-ks.org](mailto:ovp@kqz-ks.org) dhe formulari i dërguar nuk i është pranuar pasi që posta elektronike ishte e mbingarkuar. Si rrjedhojë e kësaj ajo konsideron se emri i saj nuk gjindet në listën e votuesve jashtë Kosove dhe i është mohuar e drejta për votim. Parashtruesja e apelit pretendon se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk ia ka ofruar mundësinë të aplikoj për të marrë pjesë në zgjedhje.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi KQZ-në nëpërmjet emailit më datën 31.05.2017, për apelin që është bërë ndaj vendimit të KQZ-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj apelit në po të njëjtën datë.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ nëpërmjet emailit nga zyrtari i KQZ-së, me të cilën ka theksuar se znj. Blerta Graiçevci nuk kanë mundur të gjejnë email, me të cilën të njëjtës i kanë shkruar email nga [ovpp@kqz-ks.org](mailto:ovpp@kqz-ks.org), ku të njëjtin email ia kanë bashkangjitur edhe përgjigjes të dërguar për PZAP-in. Gjithashtu KQZ ka theksuar, se

brenda intervalit 1 orë e kanë thirrur nëpërmes telefonit në numrin që figuron në formularin e ankesës dhe e njëjta nuk është përgjigjur.

PZAP-i, pasi shqyrtoi lejueshmërinë e apelit, gjeti se :

### **Apeli është i palejuar**

PZAP-i, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i palejuar sepse KQZ-ja ende nuk e ka miratuar Listën Votuese Jashtë Kosove për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017, edhe pse shihet se në përgjigjen e KQZ-së zyrtarët kanë bërë përpjekje për ta kontaktuar parashtruesen e apelit znj. Blerta Greiçevci por nuk ka qenë i mundur kontakti me të.

Andaj, mbi këtë bazë paneli vlerëson se pretendimet ankimore të parashtrueses së apelit nuk qëndrojnë për faktin se KQZ-ja, afatin për miratimin e Listës Votuese Jashtë Kosove e ka më 1qershor 2017 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017. Andaj me këtë rast paneli konstaton se apeli në këtë fazë është e palejuar për tu parashtruar, sepse PZAP-i vendos në kuptim të dispozitës të nenit 122.1 i LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lart e në mbështetje të dispozitës së nenit 118 par.1 të LZP-së, dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 20/2017 më datën 31.05.2017

**Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxhaj**



### ***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*